

VENDIM
Nr. 365, datë 20.6.2018

**PËR DHËNIEN ME KONCESION TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT LIGJOR TË
INSTRUMENTEVE MATËSE, NËPËRMJET VERIFIKIMIT TË INSTRUMENTEVE
SHPËRNDARËSE
TË KARBURANTIT DHE GAZIT TË LËNGSHËM DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË
PROCEDURËN KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, dhe në vijim të nenit 15, të rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ partneritet publik privat, miratuar me vendimin nr. 575, datë 10.7.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien me koncesion/PPP të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe të gazit të lëngshëm, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues.
 2. Miratimin e bonusit prej 10 (dhjetë) për qind të pikëve për rezultatin tekniko-financiar në procedurën konkurruese, e cila i jepet shoqërisë “Noa Control” sh.p.k.
 3. Kohëzgjatja e këtij projekti do të jetë 20 vjet, nga data e nënshkrimit të kontratës së koncesionit/PPP.
 4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi